

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6586
E shtunë, 16 prill 2022
çmimi 0.40 €

Zemaj paraqet propozimin për Projektligjin e ri për shëndetësi

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

POLICIA E KOSOVËS ËSHTË SULMUAR ME GRANATË DORE DHE KALLASHNIKOV NË VERI

FAQE 4-5



KOSOVA I BËN THIRRJE SERBISË TË DISTANCOHET NGA SULMET E DHUNSHME TERRORISTE

Institucionet e sigurisë së Republikës së Kosovës kanë bërë me dije të premtën se për tri ditë me radhë policët e Kosovës në veri janë sulmuar derisa po shkonin për ta realizuar ndërrimin në pikat kufitare. Sulmi i fundit ndaj Policisë së Kosovës ka ndodhur të enjten në mbrëmje, e cila ka qenë duke shkuar ndërrim në pikat kufitare. Ky sulm në drejtim të zyrtarëve policorë të Kosovës është bërë me granatë dore dhe kallashnikov. Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, këtë sulm e ka quajtur akt terrorist. Ai ka theksuar se angazhimi serioz i institucioneve të Kosovës për të vendosur rend dhe ligj në çdo cep të Kosovës është bërë pengesë për Serbinë. Sulmin ndaj zyrtarëve policorë e kanë dënuar edhe BE-ja, ShBA-ja dhe liderët e opozitës

AKTUALE



**KONJFUCA NDERON TË RËNËT
NË SLOVI** F. 6

**SBASHK-U PARALAJMËRON GREVA,
JASHARI: KJO QEVERI NA KA VËNË
SHKELMIN NË QAFË** F. 3

**MAQEDONIA E VERIUT DËBON EDHE
GJASHTË DIPLOMATË RUSË** F. 3

EKONOMI



**FUQIZIMI I KAPACITETEVE
ENERGJETIKE DHE EFIÇENCA
E ENERGJISË, ME RËNDËSI
PËR BIZNESET** F. 8

**ANULOHEK PROCESI I REKRUTIMIT
PËR DREJTOR MENAXHUES TË
AKP-SË, SHPALLET KONKURS I RI**

F. 8

SPORT



**SOT ZHVILLOHEN TRI NDESHJE,
NESËR DY DERBI** F. 10



PDK-ja: PËR TË GJITHË PUNËTORËT DHE TË PAPUNËT QEVERIA TË NDAJË NGA 100 EURO NË MUAJ

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Maqedonia e Veriut dëbon edhe gjashtë diplomatë rusë

SHKUP, 15 PRILL - Maqedonia e Veriut ka dëbuar të premten, 15 prill, edhe gjashtë diplomatë të tjerë nga Ambasada e Rusisë në Shkup, të cilët janë shpallur persona të padëshiruar. "Në bazë të informacioneve të marra nga organet kompetente, këta persona kryenin aktivitete që janë në kundërshtim me Konventën e Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike dhe në pesë ditët e ardhshme duhet të largohen nga territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut", thuhet në komunikatën e Ministrisë së Jashtme të Maqedonisë së Veriut (MPJ). Ambasadorit rus, Sergei Baznikin, i është komunikuar vendimi, po ashtu. Ky është dëbimi i dytë i

diplomatëve rusë në më pak se një muaj. Pesë diplomatë rusë u dëbuan më 28 mars, pasi edhe ata kishin vepruar në kundërshtim me Konventën e Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike. Edhe në vitin e kaluar Maqedonia e Veriut shpalli të padëshiruar dy diplomatë rusë, njërin në muajin maj, tjetrin në gusht. Në të dyja rastet Rusia ka reaguar me masa reciproke, gjegjësisht ka dëbuar diplomatë maqedonas nga Moska. Përpara dy dëbimeve të fundit ku janë përfshirë 11 diplomatë - sipas një liste të disponueshme në faqen e internetit të Ambasadës së Rusisë, gjithsej 19 diplomatë rusë ishin regjistruar në Maqedoninë e Veriut, duke përfshirë

ambasadorin e Federatës Ruse në vend, Sergei Baznikin dhe dy zyrtarë ushtarakë. Ambasada e Rusisë tani ka mbetur me tetë diplomatë, përfshirë ambasadorin. Maqedonia e Veriut ka dënuar pushtimin rus në Ukrainë, duke i dhënë mbështetje të plotë sovranitetit dhe integritetit territorial të Ukrainës, ndërsa u është bashkuar edhe sanksioneve të Bashkimit Evropian duke mbyllur hapësirën ajrore për fluturimet nga Moska dhe anasjelltas. Më 24 shkurt presidenti rus Vladimir Putin ka urdhëruar "operacion special" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Veprimi i Kremlinit ka nxitur zemërim dhe është dënuar në



shumë vende të botës. Shtetet e Bashkuara dhe aleatët

janë përgjigjur me sanksione të ashpra kundër Moskës.

Rusia zotohet për më shumë sulme në Kiev



Moskë, 15 prill - Ministria ruse e Mbrojtjes ka thënë të premten, se ka kryer sulme me raketa duke shënjestruar kryeqytetin ukrainas, Kievin. Ajo ka paralajmëruar se sulmet do të shtohen në shenjë hakmarrjeje ndaj atyre që i ka quajtur "sulme terroriste" dhe "akte sabotazhi" të Ukrainës në Rusi. Rusia ka thënë se raketat e saj

lundruese kanë goditur një fabrikë në qytetin ukrainas gjatë natës, e cila prodhon sisteme ajrore për mbrojtje dhe raketa kundër anijeve. Si rezultat "janë shkatërruar punëtoritë për prodhim dhe riparim të sistemeve raketore me rreze të gjatë dhe të mesme", ka thënë Ministria në një deklaratë të publikuar në kanalën e saj në

"Telegram". Të enjten Rusia ka akuzuar Ukrainën se ka dërguar helikopterë rreth kufirit për të sulmuar disa qyteza ruse. Këshilli Kombëtar për Siguri dhe Mbrojtje të Ukrainës i ka hedhur poshtë akuzat, duke i quajtur ato "përpjekje për ta rritur hysterinë anti-Ukrainës në Rusi".

Autoritetet ukrainase: Shtatë të vrarë pranë Harkivit



KIEV, 15 PRILL - Së paku shtatë persona janë vrarë dhe 27 të tjerë janë plagosur pasi forcat ruse hapën zjarr ndaj autobusëve me civilë në fshatin ukrainas Borovaya, pranë qytetit verilindor Harkiv, tha një zëdhënës i zyrës së prokurorit rajonal, raporton AP. Agjencitë ukrainase të sigurisë po punojnë për t'i përcaktuar rrethanat e sulmit, tha Dmitry Çubenko. Ai shtoi se hetuesit po

përcaktojnë gjithashtu rrugët dhe destinacionin e automjeteve që transportojnë civilë përmes territorit të kontrolluar nga Rusia rreth Borovayas. Prokuroria deklaroi se kishte nisur procedimin penal në lidhje me dyshimin për "shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës, e kombinuar me vrasje me paramendim". Pretendimet e autoriteteve ukrainase nuk ishte

e mundur të verifikoheshin në mënyrë të pavarur. Zyra e OKB-së për të Drejtat e Njeriut tha se që nga fillimi i pushtimit rus më 24 shkurt e deri më 13 prill janë vrarë të paktën 1 964 civilë. Zyra beson se numri i të vrarëve është shumë më i lartë, sepse informacionet nga disa zona vonohen për shkak të armiqësive dhe raportet e tjera janë duke pritur që të verifikohen.

Përleshje në Shanghai rreth masave kundër Covid-19

SHANGAI, 15 PRILL - Në disa pamje në rrjetet sociale në Shanghai janë parë përleshje në mes të policisë dhe banorëve të cilët janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre teksa qyteti ka hyrë në javën e tretë të izolimit për ta luftuar pandeminë e koronavirusit. Disa ndërtesa banimi janë duke u shndërruar në qendra karantine. Miliona banorë janë bllokuar nëpër shtëpitë e tyre, teksa

Shanghai përballët me shpërthim të ri të koronavirusit. Secili që rezulton pozitiv vendoset në karantinë. Me më shumë se 20 000 raste të reja në ditë, autoritetet me vështirësi po arrijnë të gjejnë hapësira të lira. Autoritetet kineze kanë shndërruar salla të ekspozitave dhe objekte të shkollave në qendra karantine, si dhe kanë krijuar spitale të përkohshme. Numri i vogël i rasteve serioze

në Shanghai ka nxitur disa banorë të pyesin nëse izolimi është i nevojshëm. Në javët e fundit shumë banorë janë ankuar nëpër rrjetet sociale për kufizimet dhe për mungesë të furnizimeve me ushqim. Kina është një prej shteteve të fundit që është ende e përkushtuar për ta zhdukur pandeminë, për dallim prej disa shteteve që po përpiqen të jetojnë me virusin.



SBASHK-u paralajmëron greva, Jashari: Kjo qeveri na ka vënë shkëlmin në qafë

PRISHTINË, 15 PRILL (ER) - Në tryezën e diskutimit me temën "Sigurimet shëndetësore dhe skemat sociale në Kosovë", të organizuar nga grupi parlamentar i AAK-së, pjesëmarrëse ishin edhe federatat sindikale të ndryshme në vend.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, e ka akuzuar qeverinë e udhëhequr nga kryeministri Kurti se nuk po hap rrugë për dialog me sindikatat dhe kështu, sipas tij, nuk po merret me problemet e punëtorëve. "Kjo qeveri që erdhi me pompozitet se do të kemi lule dritë, që kemi menduar se është partia më e afërt me sindikatat, pasi ka programin social, po del se është partia e cila na ka qitur shkëlmin në qafë, edhe për sulmin që bën kjo parti ndaj individëve të sindikatave", ka thënë Jasharaj, duke paralajmëruar edhe greva pasi, siç ka theksuar ai, janë në hall të

madh.

Duke komentuar edhe 100 eurot e fundit, ai ka thënë se, fatkeqësisht, në 21 vjetët e fundit, qeveria e tanishme është shembulli më i keq i dialogut me sindikatat. "Fatkeqësia e madhe është se në 21 vjetët e fundit qeveria e tanishme është shembulli më i keq i dialogut, madje nuk ka dialog fare dhe kjo i ka sjellë sindikatat në këtë pozitë. Është mirë që së paku opozita po hap derë për dialog. Ju deputetë, besoj se zërin tonë do ta përçoni edhe në Kuvend", ka thënë kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj.

Deputeti i AAK-së, Shemsedin Dreshaj, ka thënë se Kosova që 20 vjet përballlet me dy probleme të mëdha: me mungesë të sigurimeve shëndetësore dhe rregullimit të skemave sociale. Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se në këtë tryezë nuk janë për t'i drejtuar gishtin



askujt sa i përket mungesës së sigurimeve shëndetësore, por ka

theksuar se janë të gatshëm që ta mbështesin qeverinë lidhur

me këtë si dhe për skemat sociale.

Zemaj paraqet propozimin për Projektligjin e ri për shëndetësi

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 PRILL - Ish-ministri i Shëndetësisë, njëherësh deputet i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Armend Zemaj, ka njoftuar të premten se ka paraqitur propozimin për Projektligjin e ri për shëndetësi. Zemaj në një konferencë për medie ka thënë se shëndeti i qytetarëve nuk duhet të jetë betejë politike. "Unë sot do të paraqes para jush propozimin për Projektligjin e ri për shëndetësi, duke marrë parasysh se shëndeti i mirë dhe dinjiteti i profesionistëve shëndetësorë duhet të na bashkojë. Shëndeti i qytetarëve tonë nuk duhet të jetë betejë politike", u shpreh Zemaj.

Ai ka theksuar se në këtë projektligj kanë punuar dhe janë konsultuar shumë profesionistë shëndetësorë të fushës me qëllim të avancimit dhe përmirësimit të sistemit shëndetësor të vendit.

Zemaj ka përmendur disa çështje që rregullon Projektligji i ri për shëndetësi. "Propozon sistem funksional shëndetësor dhe të zbatueshëm, decentralizon dhe bën të zbatueshëm sistemin dytësor shëndetësor, funksionalizon



pavarësinë e shërbimeve mjekësore tretësore përmes QKUK-së, përcakton ofruesit e

shërbimeve shëndetësore, mundëson marrjen e specializimeve tërë kohën të

profesionistëve me vetëfinancim, avancojnë shërbimin shëndetësor të burjeve, rregullohet çështja e

funkcionimit të odave të profesionistëve shëndetësorë etj", ka thënë Zemaj.

Deputeti nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Armend Zemaj, ka thënë se për Projektligjin për shëndetësi ka marrë mbështetje edhe nga deputetët e tjerë nënshkrues. "Kam kënaqësinë ta procedoj Projektligjin për shëndetësi për të cilin kam marrë mbështetje edhe nga deputetët e tjerë nënshkrues. Uroj dhe shpresoj që ky projektligj të gjejë mbështetje edhe nga shumica parlamentare pavarësisht që vjen nga një deputet i opozitës", ka thënë tutje Zemaj.

Ai ka thënë se ky projektligj në përmbajtjen e tij ka 128 nene dhe se do të jetë lehtë i zbatueshëm për të mirën e qytetarëve.

Zemaj ka folur edhe për ndërtimin e qendrës emergjente. Ai ka thënë se do ta përkrahin Ministrinë e Shëndetësisë për finalizimin e saj. "Emergjencia që është ndërtuar dhe ka vite që është në atë gjendje mendoj që duhet të finalizohet dhe të jetë në shërbim të pacientëve. Mënyra se si do t'i qaset ministria besoj se do ta ketë edhe përkrahjen tonë edhe në kërkesën buxhetore", ka thënë Zemaj.

Certifikohen 101 kandidatët që kanë dhënë provimin e jurisprudencës

PRISHTINË, 15 PRILL (ER) - Në një ceremoni të organizuar nga Ministria e Drejtësisë, të premten janë certifikuar 101

kandidatë të cilët e kanë dhënë provimin e jurisprudencës. Shpërndarjen e këtyre

certifikatave e ka bërë ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e cila ka kërkuar nga kandidatët që,

pavarësisht se ku do të jenë, ta kryejnë punën me profesionalizëm dhe pa asnjë ndikim.





POLICIA E KOSOVËS ËSHTË SULMUAR ME GRANATË DORE DHE KALLASHNIKOV NË VERI

Kosova i bën thirrje Serbisë të distancohet nga sulmet e dhunshme terroriste

Institucionet e sigurisë së Republikës së Kosovës kanë bërë me dije të premtën se për tri ditë me radhë policët e Kosovës në veri janë sulmuar derisa po shkonin për ta realizuar ndërrimin në pikat kufitare. Sulmi i fundit ndaj Policisë së Kosovës ka ndodhur të enjten në mbrëmje, e cila ka qenë duke shkuar ndërrim në pikat kufitare. Ky sulm në drejtim të zyrtarëve policorë të Kosovës është bërë me granatë dore dhe kallashnikov. Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, këtë sulm e ka quajtur akt terrorist. Ai ka theksuar se angazhimi serioz i institucioneve të Kosovës për të vendosur rend dhe ligj në çdo cep të Kosovës është bërë pengesë për Serbinë. Sulmin ndaj zyrtarëve policorë e kanë dënuar edhe BE-ja, ShBA-ja dhe liderët e opozitës

**EPOKA
ERE**

MAL QORRAJ

PRISHTINË, 15 PRILL - Të premtën është sulmuar Policia e Kosovës në veri të vendit derisa ishte nisur për ta marrë detyrën në pikat kufitare me Serbinë. "Sot rreth orës 7:40 ka ndodhur një sulm ndaj Policisë së Kosovës, e cila ka qenë duke shkuar për ta marrë ndërrimin në pikat kufitare. Ky sulm, tashmë i faktuar, me granatë dore dhe AK-47, si një

akt terrorist, është bërë me qëllim të frikësimit të zyrtarëve policorë, por edhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës", ka deklaruar ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, në një konferencë të jashtëzakonshme për medie bashkë me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti.

Sveçla ka treguar se tentim-sulmi i parë ka ndodhur duke vendosur iriqje metalikë në rrugën nacionale,

në kohën përafësisht të njëjtë me sulmin e së premtës, me qëllim që ta pamundësojnë punën e Policisë së Kosovës, në të njëjtën kohë të rrezikojë jetën e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës. Sipas tij, sulmi i dytë ka ndodhur përmes gjuajtjes me gurë drejt Policisë së Kosovës. Sulmi i tretë në mbrëmjen e së enjtes është bërë me armë zjarri dhe ka ndodhur në afërsi të pikës së kontrollit për pengimin e shfrytëzimit të rrugëve ilegale.

"Tashmë po shihet që angazhimi serioz i institucioneve të Kosovës, posaçërisht i Policisë së Kosovës, që të vendosë rend dhe ligj në çdo cep të Kosovës, është bërë pengesë për Serbinë, për grupe të caktuara, të cilat mbështeten drejtpërdrejt nga Serbia dhe realisht ua prish planet të gjithë atyre të cilët Kosovën e kanë parë potencialisht si çerdhe të kriminit të tyre dhe si vazhdimësi të krizave të tjera", ka thënë Sveçla. Ministri Sveçla ka deklaruar se tri ditët e fundit janë realizuar katër sulme ndaj policëve të Kosovës në veri me qëllim të frikësimit të tyre dhe qytetarëve në përgjithësi. Ai ka thënë se qëllimi i institucioneve të Republikës së Kosovës për të vendosur rend dhe ligj dhe për ta luftuar krimin dhe korrupsionin pa dallim dhe diskriminim të çfarëdo kategorie do të vazhdojë me ngulm dhe do të jemi të suksesshëm në të drejtën tonë.

Ndërsa drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka thënë se sulmet kanë ndodhur në mënyrë sistematike, së pari janë përdorur iriqët në rrugë, sulmi me gurë, gjuajtja me armë dhe në fund gjuajtja në patrullën e Policisë së Kosovës.

Sindikata e Policisë së Kosovës ka falënderuar Policinë e Kosovës për guximin e treguar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, duke rrezikuar shëndetin dhe jetën e tyre në shërbim të qytetarëve dhe sigurisë së shtetit. "Sindikata e Policisë së Kosovës është e shqetësuar me rastin e incidenteve dhe sulmeve kundër Policisë së Kosovës të cilat kanë ndodhur ditët e fundit në veri të vendit. Edhe sot është rrezikuar drejtpërdrejt jeta e tyre. Raste të tilla ka pasur edhe në të kaluarën dhe mund të ketë edhe në të ardhmen e që kjo e pasqyron punën me rrezik për shëndetin dhe jetën e

Kirurgët e Klinikës së Kirurgjisë Vaskulare kryejnë një operacion të rrallë

PRISHTINË, 15 PRILL (ER) - Në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës është kryer një operacion i rrallë dhe i ndjeshëm për herë të parë në Kosovë. Kirurgët vaskularë, të asistuar nga ekipi i

anesteziologëve dhe ekipi i urologëve, kanë operuar një paciente të moshës 65-vjeçare me aneurizëm të Aortës Abdominale dhe me Ren Arkuata (veshka në formë të patkoit). Aneurizma e Aortës Abdominale

koekzistencë me Ren Arkuata është shumë e rrallë, ndodh vetëm në 0.12 % të rasteve në botë. Pas trajtimit disaditor në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare, pacientja është liruar për në shtëpi me gjendje stabile shëndetësore.



zyrtarëve policorë që gjatë kryerjes së detyrave zyrtare sipas ligjit dhe autorizimeve e kanë përditshmëri gjatë 24 orë në ditë.

Këto janë rastet më të freskëta që institucionet e Republikës së Kosovës ta kthejnë vëmendjen kah Policia e Kosovës dhe të reflektojnë me urgjencë që ta përmirësojnë mirëqenien dhe t'i plotësojnë kërkesat dhe nevojat për Policinë e Kosovës siç janë: Sigurimi shëndetësor dhe jetësor si dhe kushtet e punës. Sindikata e Policisë së Kosovës është aktivisht duke punuar dhe ka dhënë alternativa për plotësimin e kushteve të lartcekura dhe konkretisht për sigurimin shëndetësor dhe jetësor, është thënë në reagimin e Sindikatës së Policisë së Kosovës.

BE-ja dhe ShBA-ja dënojnë sulmin ndaj Policisë së Kosovës në veri

Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë ka dënuar ashpër atë që e ka cilësuar "sulm të dhunshëm ndaj një patrulle të Policisë së Kosovës në komunën e Zubin Potokut" në orët e hershme të 15 prillit. "Policia e Kosovës është ofruesja kryesore e sigurisë dhe përdorimi i forcës kundër zyrtarëve është i papranueshëm".



Zyra e bllokut evropian në Prishtinë u ka bërë thirrje të gjitha palëve që t'i shmangin spekulimet e panevojshme të cilat mund t'i nxisin edhe më shumë tensionet. Edhe ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka dënuar sulmin ndaj Policisë së Kosovës në afërsi të Zubin Potokut. Hovenier ka theksuar se Ambasada Amerikane është thellësisht e shqetësuar për sulmin me armë

zjarri ndaj autoriteteve sovraane të Kosovës. "Ambasada e ShBA-së është thellësisht e shqetësuar nga raportimet për të shtëna me armë zjarri dhe për hedhje të gurëve ndaj zyrtarëve policorë të Kosovës afër Zubin Potokut. Këto sulme ndodhën kur autoritetet sovraane - përgjegjëse për ruajtjen e paqes dhe sigurisë - po kryenin detyrat e tyre zyrtare", ka shkruar ai në llogarinë e vet në "Twitter".

Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Twitter", ka reaguar lidhur me sulmet kundër Policisë së Kosovës në veri. Duke cituar burimet që kanë identifikuar sulmin e së enjtes, "të ardhur nga Serbia", Kurti i ka bërë thirrje Serbisë që "të distancohet nga sulmet e dhunshme terroriste ndaj policisë sonë, disa prej të cilëve ishin serbë të Kosovës".

Ndërkohë, Blerim Vela, këshilltar i presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, nëpërmjet një reagimi në llogarinë e vet në "Twitter", ka thënë se këto veprime ndaj Policisë së Kosovës kanë për qëllim destabilizimin e situatës së sigurisë dhe asaj politike në vend.

Lidhur me sulmet ndaj Policisë së Kosovës në veri ka reaguar Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Në një postim në "Facebook", kreu i PDK-së, Memli Krasniqi, e ka dënuar sulmin, duke e quajtur "akt kriminal dhe i patolerueshëm që për qëllim ka cenimin e rendit dhe të ligjit". Krasniqi ka kërkuar nga organet e rendit që "t'i hetojnë dhe ndriçojnë rrethanat e këtij akti kriminal, si dhe t'i japin përgjigje meritore çdo përpjekjeje që cenon Kosovën dhe sovranitetin e shtetit tonë".

Edhe kreu i partisë opozitare,

Ish-ministrja Tahiri: Organet kompetente shtetërore ta rritin vigjilencën

Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka reaguar pas sulmit të Policisë së Kosovës në veri të vendit, teksa ishte nisur për ta marrë detyrën në pikat kufitare me Serbinë. Tahiri ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" se sulmet ndaj Policisë së Kosovës sot në veri të vendit vijnë nga qarqe që synojnë destabilizimin e Kosovës dhe gjithë Ballkanin. Ajo ka thënë se këto sulme vijnë në këtë kohë kur mjegulla e luftës në Ukrainë e bënë situatën e paqartë dhe alarmuese. "Organet kompetente shtetërore duhet të rritin vigjilencën dhe të veprojnë me urgjencë sipas kërkesave të sigurisë kombëtare!", ka shkruar ish-ministrja Tahiri.




Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj ka reaguar në lidhje me këtë sulm. Ai ka thënë se "këto akte kriminale janë alarm për të gjithë". "Krimi i organizuar nuk ka përkatësi politike as etnike. Ai i rrezikon të gjithë qytetarët, pavarësisht prej përkatësisë etnike, andaj është në interesin e secilit individ dhe komunitet që ta denoncojë e ta luftojë krimin", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Katër komunat në veri të Kosovës, Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zubin Potoku dhe Zveçani, janë të banuara me shumicë serbe. Policia e Kosovës në shkurt të këtij viti kishte njoftuar se ka nisur të

mbyllë disa rrugë që shfrytëzohen për kontrabandë. Sfeçla atëherë kishte thënë se mbyllja e këtyre rrugëve është tentim për të parandaluar dhe luftuar krimin dhe të gjitha format e kontrabandës në zonat kufitare që lidhin Kosovën me Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Edhe në tetor të vitit të kaluar Policia e Kosovës pati zhvilluar një aksion të gjerë kundër kontrabandës në rajonin e Prishtinës, Pejës, Mitrovicës së Jugut dhe Mitrovicës së Veriut. Policia e Kosovës pati thënë se në atë aksion ishin sekuestruar mallra "të kontrabanduara në vlerë prej qindra mijëra eurosh".



22 raste të reja me Covid në Kosovë

Prishtinë, 15 prill (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 888 testeve, 22 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19 dhe nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të premtën janë shënuar 20

qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 224 188.

Në total numri i rasteve aktive me Covid është 499. Në 24 orët e fundit janë dhënë 135 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të

gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 824 287 doza të vaksinës. Deri më sot 821 331 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 100 804 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



Tri shkolla dhe fshati Drenoc i përgjigjen aksionit për pastrimin e hapësirave publike në Malishevë

MALISHEVË, 15 PRILL (ER) - Për pastrimin e ambientit në tërë territorin e komunës së Malishevës, të premtën këtij aksioni iu përgjigjën tri shkolla dhe banorët e fshatit Drenoc. Po në këtë aksion morën pjesë përfaqësueset e institucioneve komunale dhe të kompanisë së “Ekoregionit”, njësi në Malishevë. “Pjesëmarrja ishte e madhe për pastrimin e hapësirave publike si nga institucionet komunale, po ashtu

edhe qytetarët e nxënësit, prandaj kjo gatishmëri ndihmon aksionin, pastërtinë e fshatit dhe tregon panoramën e së ardhmes për një ambient të bukur”, ka njoftuar komuna e Malishevës. Aksioni do të vazhdojë deri në fund të vitit kalendarik 2022, gjithëherë nën përkujdesjen dhe mbështetjen e drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike, Rifat Mazreku, “Task Forcës” komunale dhe sektorëve të tjerë deri në realizimin e planit operativ.



Konjufca nderon të rënë në Sllovi

LIPJAN, 15 PRILL (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka përkujtuar të rënë në Sllovi të Lipjanit, ku forcat policore e ushtarake të Serbisë masakruan 45 shqiptarë dhe plagosën 16 të tjerë. “Më 15 prill 1999 në Sllovi të Lipjanit, Serbia pushtuese masakroi 45 shqiptarë dhe i plagosi 16 të tjerë. Paramilitarët serbë plaçkitën dhe dogjën shtëpitë e tyre. Një

ditë më parë, më 14 prill, në Rugën e Kovaçevë në Mitrovicë, ushtarët e policët e Serbisë masakruan e vranë edhe 31 banorë të asaj ane. Një ditë më pas, me datën 16, në Padalishtë (Pemishtë) të Skenderajt u ekzekutuan 13 shqiptarë. Dhimbje të vazhdueshme që zemrat tona të thyera nuk do t'i harrojnë asnjëherë. Lavdi e përjetshme të gjithë të rënëve për

lirinë dhe pavarësinë e Republikës së Kosovës”, ka shkruar Konjufca në llogarinë e vet në “Facebook”. Edhe një delegacion i komunës së Lipjanit, i udhëhequr nga kryetari Imri Ahmeti, ka bërë homazhe te komplekset përkujtimore të dëshmorëve dhe të martirëve në fshatin Sllovi dhe Aklap në nderim të 23-vjetorit të rënies së tyre.



Shënohet Dita e të Pagjeturve dhe Martirëve në Mitrovicë

MITROVICË, 15 PRILL (ER) - Në ‘Shtëpinë Muze’, që ndodhet në Lagjen e Boshnjakëve në veri të Mitrovicës, të premtën është shënuar Dita e të Pagjeturve dhe Martirëve. Në këtë ditë janë përkujtuar 116 të pagjeturit shqiptarë nga rajoni i Mitrovicës, si dhe 620 martirë të vranë në luftën e fundit në Kosovë.

Në këtë aktivitet të pranishëm ishin kryetari i komunës, Bedri Hamza, kryesuesja e Kuvendit Komunal, Vesa Broja, drejtorë komunalë, kryetari i organizatës “Zëri i Prindërve”, Bajram

Çerkini, familjarë të të pagjeturve e të martirëve, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, si dhe qytetarë të tjerë, të cilët me homazhe nderuan emrat e martirëve të vendosur në pllakën përkujtimore.

Në fjalën e tij, kryetari Hamza ka thënë se muaji prill është muaji i dhimbjes dhe pikëllimit për të gjithë ne, e sidomos për familjarët e martirëve të cilët u vranë 23 vjet më parë në shtëpinë muze në Lagjen e Boshnjakëve. “23 vjet më parë në këtë shtëpi u vranë dhe u

torturuan bashkëqytetarët tanë të cilët përjetuan dhunën dhe tmerrin, mirëpo sot ne gëzojmë lirinë dhe shtetësinë tonë, falë luftës së lavdishme të UÇK-së, të NATO-s dhe aleatëve të tjerë. Me respektin më të madh përulëmi para të gjithë atyre që sakrifkuan për lirinë e vendit tonë. Lavdi dëshmorëve dhe të gjithë martirëve të luftës”, u shpreh kryetari Hamza. Pas kësaj ceremonie janë bërë homazhe dhe janë vendosur kurora me lule edhe në varrezat e martirëve të kombit në Shipol.

Përkujtohet beteja e Zhegocit me rastin e 23-vjetorit

GJILAN, 15 PRILL (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, bashkë me nënkryetaren Leonora Morina-Bunjaku, kryesuesin e Kuvendit, Arianit Sadiku dhe bashkëpunëtorët të tjerë, kanë bërë homazhe të premtën te varrezat e dëshmorëve në shënim të 23-vjetorit të betejës së Zhegocit.

Kryetari Hyseni ka thënë se përkujtimet e tilla duhet të jenë jo vetëm një akt simbolik, por një kthim prapa për të kuptuar se ku kemi qenë dhe ku kemi arritur. “Për ne si udhëheqje e komunës është shumë me rëndësi që t’i përkujtojmë ata, të cilëve u kemi për borxh që të punojmë mirë e drejtë. Përkujtimet e tilla duhet të jenë jo vetëm një akt simbolik, por një kthim prapa për të kuptuar se ku kemi qenë dhe ku kemi arritur. Nga vendi ku

pushojnë ata që kanë dhënë më të shtrenjtën për liri, u themi lavdi dëshmorëve dhe i përkujtojmë me nder dhe krenari”, ka thënë Hyseni.

Ish-komandanti i Zonës Operative të Karadakut, Ahmet Isufi, ka thënë se me betejën e Zhegocit u arrit që të përmbillet terreni i Kosovës me brigadat e zonat të cilat nën emblemën e UÇK-së sollën lirinë e Kosovës. “Beteja e Zhegocit është një nga betejat më të lavdishme të UÇK-së”, ka thënë Isufi.

Më pas, kryetari Hyseni me bashkëpunëtorët kanë bërë homazhe edhe te bustet e dëshmorëve Pajazit Ahmet e Alban Ajeti, para lapidarit të Hanet e Zhegocit dhe te të gjithë lapidarët e dëshmorëve, sikurse edhe te pllaka e dëshmorëve në Tërbovc.



PDK-ja: Për të gjithë punëtorët dhe të papunët qeveria të ndajë nga 100 euro në muaj



Stavileci ka thënë se me këto vendime qeveritarët edhe një herë dëshmuar se vendosën për formula ad-hoc, me shumë variabla të pazgjidhshme, por me vetëm një konstantë: diskriminimi i shumë kategorive dhe i të papunëve. “Pra, në vend të mbështetjes meritorie, zgjedhën lëmshëm. Në vend të ndihmës për të papunët, zgjedhën diskriminimin dhe harrimin e tyre. Në vend të barazisë sociale, zgjedhën thellimin e hendekut të pabarazisë sociale. E kur vetveten e kanë futur në kurthin e premtimeve të veta të rrejshme, e pakta që mund ta bëjnë është që të vazhdojnë për të gjithë punëtorët të ndajnë nga 100 euro deri në hyrjen në fuqi të ligjit të ri të pagave dhe të ligjit për pagën minimale në vend”, ka thënë Stavileci.

Gjoshi: Qeveria i përjashtoi veteranët nga rritja, pagat të jenë në nivelin e pagës minimale

Partia Demokratike e Kosovës e quan të papranueshëm diskriminimin që qeveria Kurti po ua bënë veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ditë më parë, në vendimin për ta bërë pagën minimale 250 euro, qeveria Kurti i ka përjashtuar tërësisht veteranët. “Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës do të vazhdojnë të mbesin të diskriminuar, të përbuzur dhe të ofenduar. Përbuzja dhe ofendimi bëhen edhe më të rënda kur vijnë nga ata që drejtojnë institucionet kryesore të shtetit, të cilat kanë obligime ligjore dhe morale ndaj tyre. Të gjithë do të përfitojnë nga rritja e pagës minimale, por jo edhe ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët nuk e braktisën kurrë Kosovën as në kohën më të rëndë të saj”, ka thënë Betim Gjoshi, sekretar për organizim dhe zgjedhje i PDK-së. Partia Demokratike e Kosovës ka përpiluar disa propozime dhe hapa konkretë që qeveria duhet të marrë urgjentisht, për t’ua kthyer dinjitetin burrave dhe grave që ishin pjesë e UÇK-së.

“1. PDK-ja propozon që qeveria duhet të vazhdojë t’u japë veteranëve pagë, së paku në lartësinë e pagës minimale, derisa të bëjë kategorizimin e tyre. 2. Partia Demokratike e Kosovës i bën thirrje qeverisë Kurti që ta nisë menjëherë pastrimin e listave të veteranëve të UÇK-së dhe kategorizimin e tyre. Ashtu siç kemi thënë shumë herë, me këtë hap jo vetëm që do të ndaloheshin përfitimet financiare për mashtruesit, por do t’i bënim nderë edhe historisë, duke larguar mashtruesit e falsifikatorët nga historia e UÇK-së, të cilës nuk i kanë takuar asnjëherë. 3. Partia Demokratike e Kosovës e fton kryeministrin Albin Kurti që të bëhet i pari që heq dorë nga të qenit veteran i rrejshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në fjalët e vartësës së tij, si mund t’i thotë vetes veteran dikush i cili nuk e ka veshur asnjë minutë uniformën e UÇK-së?! Prandaj, kryeministri Kurti duhet t’i japë fund mashtrimin të tij se ka qenë pjesë e një historie pa i takuar kurrë asaj”, ka thënë Gjoshi.

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 15 PRILL - Anëtar i kryesisë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerand Stavileci, në një konferencë për medie mbajtur të premtën, ka kritikuar qeverinë Kurti për diskriminim të qytetarëve lidhur me vendimet e fundit për përcaktimin e pagës minimale dhe ndarjes së 100 eurove për disa kategori. Stavileci ka kërkuar që qeveria të ndajë nga 100 euro në muaj për të gjithë punëtorët dhe të papunët deri në hyrjen në fuqi të Ligjit të ri të Pagave dhe Ligjit për Pagën Minimale. “Edhe përkundër vështirësive të shumta me të cilat po përballen sot qytetarët e Kosovës, tri krizave më të mëdha në historinë e tyre më të re, pandemisë,

shtrenjtimit astronomik të çmimit të rrymës dhe ngritjes marramendëse të çmimeve të prodhimeve elementare për jetesë, qeveritarët tanë, ironikisht, krejt kundër me atë për çfarë kanë marrë besimin e tyre, po e thellojnë hendekun e pabarazisë shoqërore pikërisht me taksat e vetë qytetarëve. Tani kur edhe inflacioni i çmimeve shënoi rekordin më negativ dyshifror për ta goditur akoma më shumë mirëqenien e qytetarëve të vendit tonë, qeveritarët në vend të lehtësimit të kësaj goditjeje dhe rëndimi, zgjedhën goditjen e sërishme nëpërmjet mosdëgjimit të kërkesave të tyre, anatemimit dhe diskriminimit”, ka thënë Stavileci.

PDK-ja konsideron se qytetarët, me shumë të drejtë, po kërkojnë që paga minimale të jetë më e lartë nga ajo që ka propozuar

qeveria dhe se paga minimale duhet të jetë më e lartë se 300 euro. “Qeveria ka mundësi ta bëjë një gjë të tillë. Por, a do? Kjo mbetet në ndërgjegjen institucionale dhe elektorale. U diskriminuan shumë kategori. Nga ata që me 11 euro e 10 cent në muaj apo 37 cent në ditë nuk mund ta blejnë as një kilogram bukë në ditë e deri tek të papunët që, edhe pse në numër të shumtë, s’do t’i marrin as edhe këto 37 centë. Fatkeqësisht për këta qytetarë e të papunë, qeveria është në deflacion flagrant të vizionit, ideve, planeve dhe projekteve me të cilat këto kategori të rëndësishme do të përfitonin gjatë gjithë vitit, dhe jo vetëm për një muaj të vetëm, edhe ashtu me vlerë diskrimuese dhe të pamjaftueshme”, është shprehur Stavileci.

Përurohet reparti i rinovuar i Kirurgjisë në Spitalin e Prizrenit

PRISHTINË, 15 PRILL (ER) - “Dita e sotme është një moment i rëndësishëm për zhvillimin dhe avancimin e shëndetësisë jo vetëm në Prizren, por edhe më gjerë, pasi që pacientët do të kenë kushte dhe shërbime më të mira për trajtimin e problemeve shëndetësore që ata kanë. Është në frymën e angazhimeve tona për transformimin e Kirurgjisë në Kosovë dhe vetë sistemit shëndetësor”, ka thënë të

premtën ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, me rastin e përuimit të repartit të rinovuar të Kirurgjisë në kuadër të Spitalit të Përgjithshëm “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren. Latifi ka falënderuar Qeverinë e Dukatës së Madhe të Luksemburgut e cila ka financuar këtë projekt që, sipas ministrit, për rezultat do ta ketë avancimin e ndërhyrjeve kirurgjike, rritjen e sigurisë e cilësisë për pacientët dhe

ngritjen e motivimit për personelin shëndetësor. “Ky investim dhe shumë investime të tjera që ka bërë Qeveria e Luksemburgut, si pjesë e aktiviteteve të projektit Programi mbështetës për shëndetësi në Kosovë, tregojnë më së miri se bashkëpunimi i mirë që ka Kosova dhe institucionet esaj me Qeverinë e Luksemburgut, përkthehen në përfitime për qytetarët tanë”, ka thënë Latifi.



Anulohet procesi i rekrutimit për drejtor menaxhues të AKP-së, shpallet konkurs i ri

PRISHTINË, 15 PRILL (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka njoftuar se bordi i kësaj agjencie ka anuluar procedurën e rekrutimit për postin e drejtorit menaxhues dhe ta rishpallë konkursin për këtë pozitë.

Në njoftim thuhet se: "Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pas shqyrtimit të raportit përfundimtar të komisionit të pranimit për procesin e rekrutimit për pozitën e drejtorit menaxhues të agjencisë, ku në rrethin e ngushtë ishin dy kandidatë,

vendosi që ta anulojë procedurën e rekrutimit dhe ta rishpallë konkursin për drejtor menaxhues të AKP-së".

Më tej theksohet se bordi e mori këtë vendim që ta rishpallë konkursin me qëllim që procesi i ardhshëm i konkursit të sjellë një numër më të madh të kandidatëve dhe ta rrisë konkurrencën edhe jashtë shërbimit civil, që do të ndikonte në rritjen e besueshmërisë në këtë proces të rëndësishëm.

Më 27 shtator të vitit të kaluar Valon Tolaj kishte

dhënë dorëheqje nga posti i drejtorit menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), e tek më 14 janar kjo agjenci kishte hapur konkurs për këtë pozitë.

Pas dorëheqjes së Tolajt, udhëheqësja e kësaj Agjencie ka mbetur në duart e Avni Jasharit, i cili e mban pozitën zëvendësrejtore menaxhues. Planet e qeverisë Kurti janë për shuarjen në tërësi të këtij institucioni për të pasuar nga fondi sovran, baza ligjore e të cilit është duke u përgatitur.



Fuqizimi i kapaciteteve energjetike dhe eficienta e energjisë, me rëndësi për bizneset



**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 15 PRILL - Planet e qeverisë për fuqizimin e kapaciteteve energjetike me fokus në energjinë e gjelbër si dhe tarifën e përballueshme të energjisë për konsumatorët komercialë ishin në fokus të diskutimit të organizuar

nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë me ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli.

Ministria Rizvanolli ka shpalosur para ndërmarrjeve të pranishme planet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për energjinë e gjelbër dhe ndikimin në ekonominë e qëndrueshme, si dhe punën dhe sfidat e sektorit të energjisë në vend,

si dhe rreth Strategjisë së Energjisë 2022 - 2031 e cila është në përfundim e sipër.

Ministria e Ekonomisë theksoi se strategjia përpos që synon dekarbonizimin e sektorit të energjisë në vend deri në vitin 2050, duke përbushur kështu potencialin e lartë të Kosovës për zhvillim të burimeve të

ripërtërishme, reflekton edhe përkushtimin e qeverisë sa i përket zhvillimit socio-ekonomik.

Ajo ka shtuar se strategjia ka për qëllim t'i mundësojë sektorit të energjisë të shërbejë si mjet për rritjen ekonomike të vendit dhe rritjen e mundësive të bizneseve dhe punësimit të të rinjve.

Anëtarët e pranishëm të Komitetit

të Gjelbër, Komitetit për Energji dhe Miniera dhe Komitetit për Tregti dhe Dogana të Odës Ekonomike Amerikane shprehën shqetësimet e tyre lidhur me sigurinë e furnizimit me energji, por edhe ofruan ide dhe rekomandime për sa i përket promovimit të eficientës energjetike në vend, përfshirë edhe financimin e investimeve.

Termokosi vazhdon furnizimin me ngrohje edhe për disa ditë

PRISHTINË, 15 PRILL (ER) - Ndonëse furnizimi me energji ngrohëse, sipas afatit të zakonshëm, do të duhej të përfundonte të premten, pasi është monitoruar lëvizja e temperaturave minimale ditët e fundit si dhe pasi janë analizuar parashikimet meteorologjike për një përkeqësim të motit në ditët e ardhshme, NP "Termokos"-i ka bërë me dije se furnizimi me

ngrohje do të vazhdojë edhe për disa ditë. "Në përpjekje për ta përbushur misionin tonë, që të ofrojmë ngrohje të mjaftueshme për të gjithë konsumatorët, kjo zgjatje e sezonit ngrohës është bërë në koordinim të ngushtë me komunën e Prishtinës dhe me KEK-un. Ndërkohë që është në harmoni të plotë edhe me aktet ligjore në fuqi, sipas të cilave, në rastet e temperaturave të

paqëndrueshme, mund ta vazhdojmë furnizimin e jashtëzakonshëm me ngrohje për aq kohë sa do të ketë nevojë", thuhet në komunikatën për medie.

Bëhet me dije se përfundimi i sezonit ngrohës 2021/2022, përkatësisht vazhdimi i furnizimit me ngrohje, do të varet nga lëvizja e temperaturave përgjatë ditëve në vijim.



Si mund të ndëshkohet një armik i pajisur me armë bërthamore?



Nga Ana PALACIO "Project Syndicate"

Skenat e frikshme të lëna pas tërheqjes nga Bucha, për të cilat Ukraina akuzon trupat ruse për torturimin dhe vrasjen e civilëve, e kanë intensifikuar presionin ndaj Perëndimit për të ofruar më shumë armë sulmuese për Ukrainën, dhe që Evropa të ndalë importet e energjisë ruse.

Por përtej debatit legjitim mbi gatishmërinë e Evropës për të paguar një kosto kaq të lartë në emër të Ukrainës, qëndron realiteti i zymtë se sanksionet nuk janë një formulë magjike. Për 40 vite, Shtetet e Bashkuara nuk janë shprehur qartë nëse do ta mbronin Tajvanin në rastin e një pushtimi kinez.

E megjithatë kjo qasje e mjegullt rezultoi shumë efektive në parandalimin e veprimeve të nxituara nga Kina apo nga tajvanëzët që janë shumë pro-pavarësisë. Por tani që kanë ndryshuar rethanat, duhet të ndryshojë edhe strategjia e Amerikës.

Thinjet për sanksione ndaj Rusisë nisën që shumë kohë përpara pushtimit. Kur Rusia po grumbullonte trupa pranë kufirit të Ukrainës, qeveria ukrainase dhe disa ligjvënës amerikanë i kërkuan Shteteve të Bashkuara dhe Evropës që të vendosin sanksione parandaluese, dhe t'i ofrojnë Ukrainës garanci më të forta për sigurinë.

Por udhëheqësit perëndimorë kundërshtuan, duke pretenduar se sanksionet do të pengonin aftësinë e tyre për të arritur një zgjidhje diplomatike. Tani e dimë se ato përpiqejë diplomatike ishin të kota.

Po ajo që nuk dimë, është nëse sanksionet parandaluese do ta kishin motivuar presidentin rus Vladimir Putin të ri-mendonte planet e tij, sidomos duke pasur parasysh se sanksionet parandaluese nuk do të ishin dhe aq të rënda sa paketa e masave që u vendosën pasi Kremlini e nisi pushtimin.

Tek e fundit, paketa aktuale e sanksioneve është veprimi ndëshkues më gjithëpërfshirës dhe më i koordinuar i ndërmarrë kundër një fuqie të madhe që nga Lufta e Dytë Botërore. Duke kapërcyer rezervat fillestare, Bashkimi Evropian iu bashkua SHBA-së në përjashtimin brenda pak ditësh të bankave ruse nga sistemi financiar global.

Perëndimi ngriu gjithashtu një pjesë të madhe të rezervave valutoje të Bankës Qendrore të Rusisë – një akt ky i paprecedentë, që me siguri alarmoi Kinën, rezervat zyrtare të së cilës janë 3.25 trilionë dollarë. Në fillim, u duk sikur sanksionet dhanë efektin e synuar. Brenda një jave, rubla u zhvlerësua një të tretën kundrejt dollarit amerikan. Rënia e çmimeve të aksioneve i detyroi autoritetet të pezullonin për gati 1 muaj aktivitetin në bursën e Moskës. PBB-ja e Rusisë pritet të tkurret këtë vit me 10-15 për qind.

Por edhe pse sanksionet vazhdojnë të shtohen, tregjet ruse duket se po stabilizohen. Falë ndërhyrjes së fuqishme të autoriteteve ruse, rubla po tregtohet tani afër niveleve të paralufës, ndërsa bursa e Moskës ka rikuperuar disa humbje.

Ndërsa konflikti nuk po tregon asnjë shenjë zbutjeje, qeveritë perëndimore duhet të jenë të qarta se çfarë mund të arrijnë dhe çfarë jo sanksionet, dhe mbi të gjitha sa sakrificat është e pranueshme.

Sanksionet, të përdorura për herë të parë në luftërat e Peloponezitet në Greqinë e lashtë, kanë qenë një instrument i politikës së jashtme për rreth 2500 vjet.

Ndërsa sofistikimi dhe kompleksiteti i tyre është rritur me kalimin e kohës, mekanizmi bazë ka mbetur i njëjtë: t'i shkaktojë aq dhimbje ekonomike kundërshtarit, sa ta detyrojë atë të ndryshojë sjelljen e tij. Por analiza më gjithëpërfshirëse e përdorimit të sanksioneve, e kryer nga studiuesit në Universitetin Dreksel, zbuloi se synimet e sanksioneve janë përmbushur plotësisht vetëm në 35 për qind të rasteve.

Aty ku sanksionet kanë pasur ndikim, si në Afrikën e Jugut gjatë Aparteidit, ato janë kombinuar me masa të tjera, për të çuar përpara një objektiv specifik të politikës së jashtme.

Për më tepër, edhe sanksionet e mirë-shënjestruara dhe ngrirja e asetëve kanë një efikasitet të kufizuar kundër autokracive.

Nga Koreja e Veriut në Iran, regjimet diktatoriale e mbrojnë veten dhe miqtë e tyre nga dëmet ekonomike nëpërmjet skemave të ndërlikuara që synojnë të shmangin sanksionet. Regjimi i Putinit – përfshirë miqtë e tij – është treguar i aftë që të sigurojë mos-prekjen nga sanksionet.

Në vend të tyre, janë rusët e zakonshëm, ata që do të paguajnë çmimin për sanksionet aktuale. Dhe në dallim nga shpresat e disave në Perëndim, kjo qasje nuk ka gjasa të sjellë rrezimin e Putinit nga pushteti. Diktatorët nuk janë dhe aq të prekshëm nga ndryshimet e opinionit publik.

Dhe një revolucion nuk duket se do të ndodhë, jo vetëm për shkak të

rritjes së shtypjes nga ana e Kremlinit por edhe të makinerisë së fuqishme propagandistike. Narrativa e Kremlinit thotë se duke "anuluar" kulturën ruse dhe duke ngritur sulme "të paprovokuara" mbi ekonominë e vendit, Perëndimi po përpiqet ta shkatërrtojë Rusinë, ashtu siç e kishte paralajmëruar prej kohësh Putin. Cilido në Rusi që e kundërshton "operacionin ushtarak special" në Ukrainë është një "tradhtar", "mushkonjë", dhe një njeri i gatshëm të "shesë edhe nënën e tij". Pa asnjë media të pavarur për t'i hedhur poshtë këto narratava, rusët duket se janë kryesisht të bindur me këtë propagandë.

Një sondazh i fundit nga Levada Center, tregon se 83 për qind e rusëve i miratojnë veprimet e Putinit në Ukrainë, krahasuar me 69 për qind në janar, një e dhënë kjo domethënëse, pavarësisht realiteteve komplekse në Rusi.

Ndërsa regjimi i Putinit u izolua për shkak të sanksioneve, Evropa po përballet me kostot e tyre të larta. Në botën e sotme të ndërvarur ekonomikisht, sanksionet nënkuptojnë shpesh kosto të mëdha për të dyja palët. Megjithatë ekonomitë perëndimore nuk janë shumë të varura nga Rusia në përgjithësi, Evropa mbështetet tek kjo fundit për një pjesë të madhe të energjisë që konsumon.

Prandaj ndërsa Kongresi Amerikan ka votuar për të ndaluar të gjitha importet ruse të energjisë, liderët e BE-së kanë shënjestruar vetëm qymyrimin, dhe jo naftën apo gazin. Një ndalim gjithëpërfshirës i importeve ruse të energjisë në Evropë, do të shtonte padyshim presionin mbi Kremlinin. Por një

vendim i tillë duhet trajtuar me shumë kujdes. Siç paralajmëroi së fundmi kancelari gjerman Olaf Scholz, kostot ekonomike dhe sociale të një embargoje të papritur do të ishin të mëdha.

Do të duhet kohë që Evropa të heqë plotësisht dorë nga gazi natyror rus, duke ruajtur gjithashtu stabilitetin social dhe ekonomik evropian. Po aq e rëndësishme: sanksionet janë një pjesë integrale e një strategjie më të gjerë negociuese.

Sapo Perëndimi të përdorë të gjitha armët e tij më të mëdha ekonomike, atëherë nuk do të ketë më në dispozicion asnjë mekanizëm shtesë. Ndaj mendoj se duhet të ketë hapësirë për të përshkallëzuar masat në kundërpërgjigje të veprimeve të Putinit, veçanërisht vendosjes në gatishmëri të armëve bërthamore, atyre kimike apo taktike.

Arsenali i mjeteve që mund të përdorë Perëndimi në Ukrainë është qartësisht i kufizuar. Sanksionet janë një armë e rëndësishme dhe e fuqishme, dhe ato po ushtrojnë presion mbi Kremlinin. Por duke pasur parasysh kufizimet e tyre – dhe kostot që duhet të përballojë si Perëndimi po ashtu edhe rusët e zakonshëm – ato duhet të përdoren me maturi.

Përndryshe Putin, që duket se i beson propagandës së tij paranojake dhe zotëron arsenalin më të madh bërthamor në botë, mund të arrijë në përfundimin se nuk ka asgjë për të humbur.

Shënim: Ana Palacio, një ish-Ministre e Jashtme e Spanjës, dhe ish-zëvendës-presidente e Grupit të Bankës Botërore. Aktualisht është pedagoge në Universitetin Xhorxhtaun, SHBA.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Sot zhvillohen tri ndeshje, nesër dy derbi

“Epoka e re”

PRISHTINË, 15 PRILL - Tri ndeshje të javës së 29 në BKT Superligën e Kosovës në futboll do të zhvillohen sot (e shtunë) me fillim nga ora 14:00. Vëmendja do të jetë te ndeshja në mes të Malishevës dhe Ulpianës. Të dyja këto skuadra synojnë mbetjen në elitë dhe nga kjo ndeshje do të përpiqen të nxjerrin rezultat të favorshëm. Interesante do të jetë edhe sfida tjetër në mes të Drenicës dhe Dukagjinit. Kuqezinjtë në ndeshjet e fundit kanë krizë në rezultate dhe këtë gjë synojnë ta përmirësojnë në

përballje me skuadrën nga Klina, e cila po synon ta sigurojë mbijetesën dhe gjithashtu i duhen pikët. Në ndeshjen e tretë të kësaj dite, Gjilani nuk pritët të ketë problem ndaj skuadrës së Feronikelit, e cila tashmë është pajtuar se në edicionin e ri do të bëjë gara në Ligën e Parë. Të dielën do të zhvillohen dy ndeshje derbi. Me fillim ora 13:30, në Suharekë, skuadra lidere e Superligës, Ballkani, e pret Prishtinën. Vendasit janë në seri pozitive të rezultateve dhe synojnë që me fitore ta vazhdojnë rrugën drejt titullit kampion. Në anën tjetër, Prishtina ka mbetur pas në

garën për titull e, po ashtu, është eliminuar nga gara e Kupës. Të dielën në stadiumin “Zahir Pajaziti” përballen Llapi dhe Drita. Synim i këtyre dy skuadrave është fitorja në këtë ndeshje, pasi të dyja ende janë në garë për titull. Këto skuadra do të përballen edhe në finale të Kupës.

SUPERLIGA - Java 29

Të shtunën takohen:
14:00 Malisheva - Ulpiana
14:00 Drenica - Dukagjini
14:00 Gjilani - Feronikeli

Të dielën takohen:
13:30 Ballkani - Prishtina



Superliga e basketbollit sjell derbin e skuadrave prizrenase



Prishtinë, 15 prill - Ndeshja e dytë e javës e 27-të në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll zhvillohet sot (e shtunë) mes rivalëve lokalë, Prizrenit 16 dhe Bashkimit. Basketbollistët e Prizrenit 16 kanë 15 fitore dhe 11 humbje, ndërsa “portokallezinjtë” kanë dhjetë fitore e 16 humbje, duke u renditur në vendin e shtatë dhe kërkojnë të hyjnë në zonën e “play-off”-it, pasi kanë një pikë më pak se

Rahoveci. Të dielën do të zhvillohet derbi i rivalëve të vjetër të basketbollit të Kosovës, Sigal Prishtinës dhe Trepçës. Prishtinasit kanë 13 fitore e 13 humbje, kurse mitrovicasit kanë 18 fitore e tetë humbje. Sfidat mes këtyre dy skuadrave kanë qenë gjithmonë interesante dhe kështu pritët edhe në këtë përballje. Sfida e fundit zhvillohet ndërmjet Rahovecit dhe Golden Eagle Yllit. Vreshtarët kanë 11 fitore

e 15 humbje, kurse therandasit kanë 20 fitore e gjashtë humbje. Therandasit ndodhen në vendin e gjashtë, kurse kampionët në vendin e parë.

SUPERLIGA - Java 27

Të shtunën takohen:
20:30 Bashkimi - Prizreni 16

Të dielën takohen:
17:00 Sigal Prishtina - Trepça
20:30 Rahoveci - Golden Eagle Ylli

Çeku: Kuvendi Zgjedhor i FFK-së mund të përfundojë në gjyq

PRISHTINË, 15 PRILL - Rreth zgjedhjeve të përfunduara në Federatën e Futbollit të Kosovës ka folur edhe Hajrullah Çeku, ministër në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. I pari i MKRS-së ka thënë se kanë pasur komunikim zyrtar me FFK-në dhe i kanë njoftuar ata për mendimet e tyre ligjore. Çeku ka thënë në Kanal 10 se janë

duke përgatitur pozicionin përfundimtar i cili mund të përfundojë edhe në instancat gjyqësore. “Ne kemi pasur një komunikim zyrtar me FFK-në. I kemi njoftuar ata për mendimet tona ligjore rreth rregullsisë, ligjshmërisë së shpalljes së zgjedhjeve të brendshme. Kemi kërkuar sqarime nga FFK-ja për dyshimet që i kemi ngritur”. Ai



ka thënë se në lidhje me këto dyshime dhe sqarimet e kërkuara kanë pranuar përgjigje nga FFK dhe janë duke u përgatitur për pozicionin përfundimtar. “Ne i kemi pranuar përgjigjet e FFK-së dhe jemi duke u përgatitur për pozicionin përfundimtar i cili, mbase, mund të përfundojë edhe në instancat gjyqësore”, ka thënë

25 mijë euro shpërblime për Final 4 të Ligës Unike

PRISHTINË, 15 PRILL - Më 20 dhe 21 prill në palestrën “Karagaçi” të Pejës do të organizohet Final 4 i Ligës Unike. Kjo është hera e parë që kjo ngjarje organizohet në Kosovë. Në konkurrencën e

meshkujve Liga Unike do të ofrojë shpërblime për dy gjysmëfinalistët nga 3 000 euro, për finalistët nga 5 000 euro dhe për klubin i cili shpallet Kampion i Ligës Unike do të ndahen 9 000 euro

(25 000 euro gjithsej). Pra, në përgjithësi do të jenë 25 mijë euro shpërblime në total. Më 20 prill në gjysmëfinalen e parë do të takohen Golden Eagle Ylli-Teuta e Durrësit nga ora 17:00, kurse nga ora 20:30

zhvillohet gjysmëfinalja e dytë Peja-Prizreni 16. Më 21 prill zhvillohet ndeshja për vendin e tretë dhe finalja e madhe. Spektakël i madh i basketbollit pritët në Final 4 të Ligës Unike.



Kampioni i botës, i zhgënjyer nga Yamaha, gati të kalojë te rivalët

NICE, 15 PRILL - Piloti francez Fabio Quartararo, kampion bote në MotoGP, nuk ka vendosur ende se çfarë do të bëjë sezonin e ardhshëm. Ky sezon nuk ka nisur mirë për pilotin e Yamahas, ndaj po sheh mundësinë që të largohet

në fund të vitit. "Kemi shumë opsione në tavolinë, por nuk do të nxitohemi për të ardhmen, pasi ka ende kohë përpara", u shpreh 22-vjeçari. "Ne jemi në bisedime edhe me Yamahan për ta rinovuar kontratën, por duhet parë edhe

se çfarë motori do të ofrojë. Ky sezon është i vështirë, pasi nuk kemi fituar asnjë garë. Janë të shumtë pilotët që do të jenë pa kontratë në fund të këtij sezoni, ndaj mund të ketë shumë surpriza", ka shtuar Quartararo. Vetëm tre pilotët kanë një

kontratë të sigurt për vitin 2023: Francesco Bagnaia (Ducati), Marc Marquez (Honda) dhe Brad Binder (KTM). Për momentin, "El Diabolo" po sheh mundësitë, por Honda e Ducati mund t'i ofrojnë një motor kompetitiv



për vitin 2023. Pritet që gjithçka të vendoset brenda korrikut.

KF Liria bëhet me pronar të ri

PRIZREN, 15 PRILL - KF Liria e Prizrenit është bërë me pronar të ri është bërë me dije në një konferencë për medie nga klubi prizrenas. Raman Kiqe-KA-Sportmanagment është shpallur fitues për marrjen në pronësi e menaxhim të KF Liria. Në garë ishin dy kandidatë, Agim Buduri dhe Raman Kiqe. Buduri në fund mori 392 pikë, kurse Raman Kiqe 566. Kryetari Qemal Krasniqi njoftoi në emër të komisionit për punën e bërë deri më tash, për procedurat dhe gjithë angazhimin në këtë proces, me ç'rast falënderoi edhe DKRS-në për ndihmën e dhënë në këtë rast. Krahas anëtarëve të komisionit mori pjesë edhe Mirsad Çollaku, anëtar i KE të FFK-së dhe kryetar i LRF në Prizren. "Më 14.04.2022 në ndërtesën e Kuvendit Komunal, para anëtarëve të Komisionit të KF Liria, lidhur me Thirrjen Publike, datë 31.03.2022, ofertat i kanë paraqitur dy aplikuesit: Agim Buduri dhe Raman Kiqe. Ata kanë



shprehur interesim në këtë thirrje për marrjen në pronësi e menaxhim të KF Liria. Prezantimi u bë një nga një, nga pjesëmarrësit në këtë Thirrje Publike, ku shpaleshë programin dhjetëvjeçar (2022-2032), duke u përgjigjur edhe në pyetjet shtesë të anëtarëve të Komisionit", ka thënë Krasniqi.

Pas përfundimit të paraqitjeve të planprogrameve zhvillimore dhe atyre financiare, komisioni gjashtanëtarësh vlerësoi në këtë mënyrë: Agim Buduri 392 pikë dhe Raman Kiqe 566 pikë. Fitues u shpall Raman Kiqe - KA-Sportmanagment që mblodhi 566 pikë.

Xavi: Ishte një natë fatale, dështuam për ta arritur objektivin tonë

BARCELONË, 15 PRILL - Barcelona i ka thënë "lamtumirë" Ligës së Evropës, pasi është mposhtur nga gjermanët e Eintracht Frankfurtit, një shkualifikim që dhemb edhe më shumë, duke marrë parasysh se ndodhi në "Camp Nou". Skuadra gjermane ishte më efektive në këtë përballje edhe pse katalanasit e Xavi Hernandezit dominuan në lojë. Pas ndeshjes trajneri spanjoll foli për këtë takim, duke e konsideruar natë fatale dhe se skuadra e tij dështoi ta arrijë objektivin në këtë sezon. "Ne u përpoqëm, por problemi ishte ai i futbollit. Ne e kishim topin, por nuk dinim si ta përfitonim. Ishte një natë fatale. Bëmë shumë gabime. Goli i dytë ishte një top i humbur nga ne. Penalltia ishte, gjithashtu, gabim. Goli i tretë, gjithashtu. Është diçka për të cilën folëm dhe nuk mund të ndodhë. Duhet të jemi autokritikë. Nuk ishim mirë dhe kjo është arsyeja pse jemi



eliminuar. Ishin tri koncepte për ta shmangur përsëritjen e ndeshjes së parë: intensiteti,

zvogëlimi i rasteve të humbjeve të topit dhe të dinim t'i ndalonim kundërsulmet", ka thënë Xavi.

SHKURT

Vojvoda, afër Milanit

Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës, Mërgim Vojvoda, thuhet se ka arritur marrëveshje me gjigantin italian, Milan. Sipas asaj që raporton gazetari i njohur Arlind Sadiku, Vojvoda është takuar me drejtorin sportiv, Paolo Maldini, dhe kanë arritur marrëveshje. Milani pritet që në verë t'i dërgojë Torinos ofertën zyrtare. Vojvoda pas paraqitjeve të mira në kampionatin italian, shumë klube evropiane kanë shprehur interesim për të. Futbollisti nga Kosova me Torinon në të gjitha garat ka zhvilluar 25 paraqitje, teksa ka kontribuar me dy asistime.

Kane refuzon Unitedin

Harry Kane është i gatshëm ta refuzojë edhe një herë tjetër ofertën e Manchester Unitedit. "Mirror" raporton se Harry Kane ka vendosur të qëndrojë sërish në Londër, te Tottenham Hotspur. Përcaktues për këtë vendim është edhe trajneri Antonio Conte. Me italianin në stol, Kane është rikthyer në formë dhe është i bindur se mund të përmirësohet më shumë, ndërsa në sezonin e ri pritet të nisin një projekt edhe më gjigant me shpresën për ta rikthyer Tottenhamin te trofetë.

Burnley shkarkon trajnerin Dyche

Klubi anglez Burnley ka shkarkuar trajnerin Sean Dyche, me klubin që gjendet vetëm katër pikë larg zonën e shpëtimit nga rënia nga Premierë Liga. Dyche ishte një nga menaxherët më jetëgjatë në futbollin anglez, pasi mori drejtimin e Burnleyt në vitin 2012. Ai e udhëhoqi klubin drejt dy promovimeve në Ligën Premierë gjatë kohës së tij në Turf Moor dhe ishte menaxheri më jetëgjatë në ligën e elitare. Por, ai tani është shkarkuar pas humbjes 2-0 të së shtunës ndaj Norwich Cityt, që e la Burnleyn në vendin e 17 në ligë - katër pikë prapa Evertonit të vendit të 16 me tetë ndeshje të mbetura deri në fund të sezonit. "Burnley Football Club mund të konfirmojë se klubi është ndarë me menaxherin Sean Dyche, ndihmësmenaxherin Ian Woan, trajnerin e ekipit të parë Steve Stone dhe trajnerin e portierëve Billy Mercer", thuhet në njoftimin e klubit anglez Burnley.

Përfundon sezoni për Pedrin

Pedri do ta humbasë pjesën tjetër të sezonit 2021/22, pasi u lëndua në ndeshjen kundër Eintracht Frankfurtit. "Testet e së premtes në mëngjes kanë zbuluar se Pedri ka një lëndim. Kjo do të thotë se ai nuk do të jetë i disponueshëm për përzgjedhje derisa të rikuperohet nga lëndimi", thuhet në njoftimin e Barcelonës. Klubi nuk ka specifikuar afatin kohor për dëmtimin e 19-vjeçarit, por ai duket se do të jetë jashtë fushës për të paktën një muaj. Trajneri Xavi Hernandez nuk do të dëshirojë ta rrezikojë atë duke pasur parasysh problemet me dëmtimet me të cilat u përball në gjysmën e parë të sezonit.

Ten Hagen nuk llogarit në Ronaldon

Erik ten Hag i ka dhënë dritën jeshile Cristiano Ronaldos për t'u larguar nga Manchester Unitedi këtë verë. Ten Hag është gati të bëhet trajneri i ardhshëm i Unitedit pasi ka rënë dakord

për një marrëveshje në parim me drejtuesit e klubit. Dhe holandezi është pro largimit të Ronaldos, pasi e ka bërë të qartë se legjenda e Unitedit nuk do të jetë pjesë e

planeve të tij afatgjata në "Old Trafford". Lajmi do t'i mahnitë tifozët e Unitedit, të cilët ende e konsiderojnë Ronaldon si një figurë ikonike në klub, pavarësisht prej vështirësive të

tij këtë sezon. Mbështetësit ishin të entuziazmuar verën e kaluar kur Ronaldo, 37 vjeç, shpërfilli rivalët e Manchester Cityt për të bërë një rikthim mahnitës tek Unitedi nga

Juventusit në një marrëveshje prej 12 milionë funtesh. Ai pritej t'i ndihmonte gjigantët të garonin përsëri për trofe, por magjia e tij e dytë është kthyer në një ankh.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM
PËR TË RRIUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE
I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND
ADULT EDUCATION

Njoftim

Hapja dhe vlerësimi i ofertave për ekskursion në Shqipëri për Qendrën e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë, shtyhet për ditën e marte (19.04.2022), pasi që sipas datës së shpalljes i bie që hapja dhe vlerësimi të bëhet ditën e shtunë, mirëpo është ditë pushimi.

NJOFTIM ZBRITJE MALLI DERI 75 %

Biznesi individual me numër Unik Identifikues 810497398 me seli në Llapna Sell dhe nr. kontakti 044777778, për arsye të likuiditetit, njofton të interesuarit qytetarë si persona fizik apo juridik mund të blejnë produkte kozmetike grimi të brendeve botërore MAX FACTOR, ARTDECO, parfuma, deodorante, qumësht trupi etj, të firmave botërore BOSS, BALDESSARINI, D&G, Lacoste, Moschino, Valentino, Versace, ngjyra flokësh, pajisje tretmani dhe mirëmbajtje floku të prodhuesit Italian DIKSON.

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek “REB BULLI”, në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:
044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Emin Haziraj shpall te pavlefshme dy dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Sylejman Ramanaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Naim Frasheri " Kobaje.
- ▶ “Sri Consulting” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811889552.
- ▶ “Vezë Fan” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811889726.
- ▶ Rebeka Lohaj shpall të pavlefshëm letërnjoftimin me numër: 1174178352 të lëshuar nga MPB-ja me datë 07.09.2016.
- ▶ Avdyl Hajdaraj nga Gjakova shpall të pavlefshme gjimnazit “Hajdar Dushi”-Gjakovë.
- ▶ Endrit Halilaj nga Lipoveci i Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U ‘Shaban Golaj’.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoh një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Statisticient i lartë (zyrtar i lartë)

Departamenti: Statistikës

Divizioni: Statistikave të Bilancit të Pagesave

I raporton: Udhëheqësi i Divizionit të Statistikave të Bilancit të Pagesave

Niveli i gradës: 5

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zbaton programin afatshkurtër të Divizionit të Statistikave të Bilancit të pagesave në kuadër të Departamentit të Statistikës në pajtueshmëri me përkrahimin e detyrave dhe përgjegjësi të punës;
- Mbledhë, përpilon dhe validon statistikave të sektorit të jashtëm me qëllim të rritjes së cilësisë dhe përfshirjes të funksionit statistikor në BQK në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare;
- Përgatitë statistikave për publikimet periodike dhe jo periodike në pajtueshmëri me politikën e publikimeve dhe me përvojat më të mira lidhur me shpërndarjen e informatave statistikore;
- Jep mendime dhe rekomandime lidhur me çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me mbledhjen, përpilimin, validimin dhe publikimin e informatave statistikore;
- Propozon dhe merr pjesë në mënyrë aktive në hartimin e metodologjisë së përpilimit të statistikave, zhvillimin e procedurave të punës si dhe dokumenteve tjera administrative të Departamentit të Statistikës;
- Përcjellë dhe merre pjesë aktive në procesin e trajnimit të personelit të ri në Departamentin e Statistikës;
- Mbanë bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët për mbledhjen e informatave dhe çështjet tjera statistikore;
- Kryen punë të tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

Edukimi:

- Nivel universitar në ekonomi, statistikë, financë ose disiplina të ngjashme. Niveli pasuniversitar është i dëshirueshëm.

Përvoja e punës:

- Së paku tre (3) vjet përvojë pune në statistikë ose disiplina të ngjashme.

Njohja e gjuhëve të huaja:

- Të jetë i/e rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe/ose serbe dhe në gjuhën angleze.

Kërkesat tjera:

- Të posedoj vetiniciativë, aftësi të mira të komunikimit dhe koordinimit;
- Të ketë aftësi numerike, analitike dhe aftësi të zgjedhjes së problemeve;
- Të ketë aftësi të mira për të punuar i pavarur dhe të jetë konstruktiv në punë ekipore;
- Të posedoj aftësi të caktimit të prioriteteve dhe të jetë i përpiktë në përmblidhjen e afateve të publikimit të statistikave sipas kalendarit paraprak të publikuar dhe i gatshëm për përmblidhjen e afateve dhe kërkesave të paplanifikuara;
- Vëmendje e madhe ndaj detajeve dhe aftësi ndër personale.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **04 Maj 2022**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**



OBJAVLJIVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Pozicija: Viši statističar (viši službenik)

Odeljenje: Statistika

Divizija: Statistike platnog bilansa

Izveštava: Rukovodiocu Divizije za statistike platnog bilansa

Stepen: 5

Dužnosti i odgovornosti:

- Sprovodi kratkoročni program Divizije za statistike platnog bilansa u okviru Odeljenja za statistiku u skladu sa opisom radnih zadataka i odgovornosti;
- Prikuplja, sastavlja i validira statistike spoljnog sektora u cilju povećanja kvaliteta i uključivanja statističke funkcije u CBK-u u skladu sa međunarodnim standardima;
- Priprema statistike za periodična i ne periodična objavljivanja u skladu sa politikom objavljivanja i sa najboljim iskustvima vezano za distribuciju statističkih informacija;
- Daje mišljenja i preporuke o raznim pitanjima koje se odnose na prikupljanje, sastavljanje, validiranje i objavljivanje statističkih informacija;
- Predlaže i aktivno učestvuje u izradi metodologije za izradu statistika, razvoj radnih procedura kao i drugih administrativnih dokumenata Odeljenja za statistiku;
- Prati i aktivno učestvuje u procesu obuke novog osoblja u Odeljenju za statistiku;
- Održava potrebnu saradnju sa svim stranama za prikupljanje informacija i ostalih statističkih pitanja;
- Obavlja druge poslove na zahtev nadzornika.

Obrazovanje:

- Univerzitetski nivo u ekonomiji, statistici, finansijama ili sličnim disciplinama. Post univerzitetske studije su poželjne.

Radno iskustvo:

- Najmanje tri (3) godine radnog iskustva u statistici ili sličnim disciplinama.

Poznavanje stranih jezika:

- Da tečno govori albanski i/ili srpski jezik i engleski jezik.

Ostali uslovi:

- Da poseduje samoinicijativu, dobre komunikacione i koordinacione veštine;
- Da poseduje numeričke, analitičke i veštine za rešavanje problema;
- Da poseduje dobre sposobnosti za samostalan rad i da bude konstruktivan u timskom radu;
- Da poseduje sposobnosti za određivanje prioriteta i da bude precizan u ispunjenju rokova za objavljivanje statistika prema prethodno objavljenom kalendaru i da bude spreman za ispunjenje neplaniranih rokova i zahteva;
- Velika pažnja prema detaljima i međuljudske veštine.

Svi kandidati moraju da dostave sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Prateće (motivaciono) pismo gde se naglašava interesovanje za ovu poziciju;
- Potvrda o radnom iskustvu izdata od strane nadležne institucije/organizacije podržana potvrdom iz Trusta;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju da budu zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Uverenje o identitetu i stalnom boravku na Kosovu.

Postupak za apliciranje:

- Poslednji rok za apliciranje je **04 maj 2022**.
- Apliciranje se može uraditi online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi način apliciranja neće se uzeti u obzir.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti preko zvanične stranice: www.bqk-kos.org
- **Nepotpune dokumentacije neće biti razmatrane. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues